

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DORIANA A. PELLUMBI  
ADRESA NR.5, JANOS HYNVADI  
TEL: 676359087

# VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 775

Tirane më 15/07/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2024051070035593799

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER DORIANA A. PELLUMBI



DATE 15/07/2024  
NR REP 775

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15.07.2024, para meje Notere DORIANA A. PELLUMBI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, JANOS HYNVADI, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:** Frenki Bozo, atësia Pietri, amësia Esmeralda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Agron Jano; Nd. 18; H. 1; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 21/01/1998, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033380156 dhe nr. personal J80121052P.

Individet e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqërisë 21 Entertainment SHPK", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

DORIANA A. PELLUMBI

## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “21 ENTERTAINMENT” SHPK

Sot, më 15/07/2024, u themelua kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vijim,

“Ligji për Shoqëritë Tregtare”), nga ortaku i vetëm:

- (i) **Z. Frenki Bozo**, atësia Pietri, shtetas shqiptar, identifikuar me Pasaportën nr. BD2848062 dhe me nr. personal J80121052P, lindur më 21/01/1998 në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

*Shoqëria dhe marrëdhëniet e brendshme të saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe dispozitat e këtij Statuti (në vijim “Statuti”).*

## KAPITULLI I

### EMRI, SELIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, DEGËT, PËRGJEGJËSITË E ORTAKUT

#### NENI 1

##### THEMELIMI DHE EMRI

1.1 Me datë 15/07/2024, Ortaku më lart themeloi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “21 Entertainment” (në vijim “Shoqëria”). Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar shqiptar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### NENI 2

##### FORMA LIGJORE

“21 Entertainment” është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Gjatë kohëzgjatjes së saj, emri i Shoqërisë do të ndiqet nga prapashtesa “SHPK” duke treguar formën e saj ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.



*Frenki Bozo*

### **NENI 3**

#### **SELIA**

- 3.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Naim Frashëri, nr. 36, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **NENI 4**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë në Shqipëri dhe jashtë saj është si më poshtë:

Organizimi i aktiviteteve të argëtimit, artit dhe kulturës, duke përfshirë por mos u kufizuar në, festivale, spektakle, sfilata mode, filma, etj. Ofimi i shërbimeve të promovimit dhe menaxhimit si agjent i personave që punojnë në fushën e modelingut. Negocimi dhe mundësimi i marrëdhënieve kontraktore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit me kërkesë dhe në favor të modeleve që punojnë në fushën e modelingut. Promovimi dhe menaxhimi i personave me ndikim në rrjete sociale për marrëdhënie bashkëpunimi me bizneset. Të gjitha aktivitetet e tjera që lejohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi lidhur me fushën e argëtimit, artit, kulturës, promovimit dhe të ndërthurur me fushën e marketingut.

- 4.2 Për të arritur qëllimin e objektit, Shoqëria mund të kryejë transaksione tregtare, industriale, për sende të luajtshme, të paluajtshme dhe transaksione financiare të çdo lloji, por jo si objekt kryesor dhe jo në raport me publikun, përfshirë çështjen e garancive dhe garancive të tjera reale dhe personale si në favor të vetes ashtu edhe të palëve të treta, nëse janë në interes të Shoqërisë.
- 4.3 Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këtij Statuti. Shoqëria gjithashtu mund të hapë degë të saj jashtë Shqipërisë.

### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA**

- 5.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj për një periudhë të pakufizuar kohore, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar.
- 5.2 Shoqëria mund të ndryshojë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut.

 2

## NENI 6

### DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT

Shoqëria mund të hapë degë, shoqëri të kontrolluara, zyra përfaqësimi dhe të kryejë veprimtari biznesi në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## NENI 7

### PËRGJEGJËSITË E ORTAKUT

7.1 Ortaku nuk është përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë. Ai mbulon personalisht humbjet e saj deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera.

7.2 Ortaku do të ushtrojë detyrat e tij me kujdesin e duhur dhe ndershmëri në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

7.3 Ortaku mund të përjashtohet për një arsye të drejtë kur:

- i detyruar të ofrojë punë ose shërbime me anë të kontributit, nuk është më në gjendje të përmbushë detyrimet e marra;
- i nënshtrohet procedurave të falimentimit;
- është në mungesë të përmbushjes së detyrimeve të marra ndaj kompanisë;
- fiton drejtpërdrejt ose tërthorazi aktivitete në konkurrencë me atë të kompanisë.

Përjashtimi duhet të vendoset nga ortakët unanimisht. Ortaku, përjashtimi i të cilit po votohet nuk llogaritet në numër.

Vendimi i përjashtimit duhet t'i njoftohet ortakut të përjashtuar dhe përjashtimi do të hyjë në fuqi pas tridhjetë ditësh nga njoftimi i lartpërmendur. Brenda kësaj periudhe, ortakut i përjashtuar mund të bëjë një kundërshtim para gjykatës. Nëse shoqëria përbëhet nga vetëm dy ortakë, përjashtimi i njërit prej tyre shpallet nga gjykata me kërkesë të tjetrit.

Ortakut i përjashtuar ka të drejtën e likuidimit të kuotave të tij në këtë drejtim, duke përjashtuar mundësinë e rimbursimit të kuotave duke zvogëluar kapitalin e shoqërisë.

## KAPITULLI II

### KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË PËRBASHKËT, TRANSFERIMI I KUOTAVE

3  
*F. Boko*

## NENI 8

### KAPITALI DHE KUOTAT

- 8.1 Kapitali i shoqërisë është në para, i barabartë me 10,000 (dhjetë mijë) lekë. Kapitali i Shoqërisë është i paguar.
- 8.2 Kapitali i Shoqërisë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, është në pronësi dhe tërësisht i nënshkruar nga ortaku:
- (i) **Z. Frenki Bozo.**

## NENI 9

### ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## NENI 10

### ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet deri në kufirin e lejuar nga ligji me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## NENI 11

### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TË REGJISTRUAR

- 11.1 Transferimi i kuotave do të realizohet vetëm nëpërmjet një dokumenti të shkruar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 11.2 Nëse kapitali i Shoqërisë zotërohet nga më shumë se 1 (një) Ortak, kufizimet vijuese (siç përcaktohen në pikat 11.3 e vijuese të këtij neni) do të zbatohen në lidhje me transferimin e kuotave, me qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, unitetin e Ortakëve dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënies së tyre.
- 11.3 Në rast se një Ortak dëshiron të transferojë kuotën e tij (përfshirë një transferim pa kompesim) te palët e treta, transferimi i nënshtrohet të drejtës së parablerjes të Ortakëve ekzistues të Shoqërisë në lidhje me kuotën (pjesën e kuotës) që synohet të transferohet, në përputhje me sa parashikohet në pikat 11.4 e vijuese më poshtë.



Për shmangjen e çdo dyshimi, transferimi i kuotave tek një palë e tretë në shkelje të të drejtave të parablerjes së Ortakëve të tjerë është i parregullt dhe, për këtë arsye, është i pavlefshëm.

- 11.4 Ortaku që synon të shesë ose të transferojë pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë ose ndonjë pjesë të tij, duhet të njoftojë përmes një shkrese zyrtare ose përmes postës elektronike ("Njoftim i Transferimit") Ortakët e tjerë. Njoftimi duhet të përfshijë të dhënat personale të transferuesit dhe identifikimin e përfituesit, vlerën e kuotës (ose një pjesë e saj) që synohet të transferohet, kushtet dhe afatet e transferimit, përfshirë çmimin ("Çmimi i Përshkruar") dhe mënyrën e pagesës.
- 11.5 Njoftimi i Transferimit do të specifikojë një periudhë ("Periudha e Përshkruar") e cila nuk do të jetë më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data pasardhëse e lëshimit të Njoftimit për Transferim, periudhë brenda së cilës oferta duhet të pranohet ose refuzohet. Njoftimi për Transferim, pas dërgimit të tij, është i pakthyeshem.
- 11.6 Çmimi i Përshkruar do të jetë një çmim që do të përcaktohet nga transferuesi dhe do të konsiderohet se pasqyron një vlerë të drejtë të kuotës.
- 11.7 Ortaku i njoftuar duhet të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes mbi pjesëmarrjen e Ortakut/transfëruesit të treguar në njoftim, duke i dërguar Ortakut që ofron dhe administratorit, deklaratën për ushtrimin e së drejtës së tij të parablerjes me një shkrese zyrtare brenda afatit të parashikuar në njoftim.
- 11.8 Nëse, deri në fund të Periudhës së Përshkruar, nuk është marrë asnjë njoftim pranimi ose jo, e gjithë pjesa (ose një pjesë e saj) në Njoftimin e Transferimit nuk është pranuar nga blerësi, transferuesi do të ketë të drejtë të transferojë pjesën e tij të një palë e tretë në një çmim i cili nuk është më i ulët se Çmimi i Përshkruar. Transferuesi do të njoftojë paraprakisht me shkrim identitetin e palës së tretë ("Transferuesi i Synuar") të cilit ai synon t'ia shesë kuotën (ose një pjesë të saj), Ortakëve të tjerë të shoqërisë.
- 11.9 Pëlqimi me shkrim i Ortakëve të tjerë, për transferimin e kuotave tek Transferuesi i Synuar, do të konsiderohet një kusht paraprak për të drejtën e Ortakut për të transferuar pjesën e tij (ose një pjesë të saj) të Transferuesit i Synuar.
- 11.10 Asnjë Ortak nuk lejohet të vendosë si garanci, të lërë peng apo të ngarkojë me barrë tjetër kuotën perkatëse dhe asnjë Ortak nuk do të japë opion apo të drejta të tjera për të

5  
Fozeko

disponuar ndonjë interes mbi kuotat e zotëruara prej tyre (përveç transferimit në përputhje me dispozitat e këtij neni), pa miratimin e Ortakut tjetër. Asnjë Ortak nuk do të hyjë në ndonjë marrëveshje në lidhje me të drejtat e votës që lind nga posedimi i kuotës përkatëse ose tituj në Shoqëri ose të japë ndonjë opsion në lidhje me to, pa miratimin e Ortakut tjetër. Dispozitat e kësaj pike mund të shfuqizohen vetëm në bazë të nje vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.

- 11.11 Çdo transferim i kryer në kundërshtim me dispozitat e mësipërme të këtij neni do të konsiderohet i pavlefshëm dhe Ortaku transferues do të jetë përgjegjës ndaj Ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmet e shkaktuara.
- 11.12 Dispozitat e këtij neni zbatohen gjithashtu për pasardhësit ligjorë dhe/ose testamentarë të Ortakëve (sipas rastit).

### KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISË

#### NENI 12

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asambesë së Përgjithshme, kur merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut, janë të detyrueshme për Shoqërinë. Asambleja e Përgjithshme e kësaj shoqërie në themelimin e saj përbëhet nga Ortaku i Vetëm. Gjatë aktivitetit të saj mund të shtohen ortakë të tjerë, dhe në këtë rast do të zbatohen dispozitat e këtij Statuti për organizimin e brendshëm të shoqërisë nga më shumë së një ortak.

#### NENI 13

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për të vendosur në lidhje me çështjet si vijon:
- a) përcaktimin e politikave financiare të Shoqërisë;
  - b) ndryshimin e Statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve;

6  




- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe audituesve ligjorë;
- e) ndarjen e kuotave dhe anulimin e tyre;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare, të raporteve të administrimit dhe mbikëqyrjes, përfshirë por pa u kufizuar, raportet vjetore të ecurisë së Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale në lidhje me mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme;
- i) miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
- j) miratimin e skemës së shpërblimit për administratorin/ët, likuiduesit dhe audituesit ligjorë;
- k) ristrukturimin, prishjen, transformimin, bashkimin, ose likuidimin e Shoqërisë ose riorganizimin e saj në një formë tjetër ligjore;
- l) ndryshimin e statusit ligjor dhe/ose formës ligjore apo mbylljen e Shoqërisë;
- m) blerjen e kuotave/aksioneve në shoqëri të tjera ose transferimin e kuotave/aksioneve të Shoqërisë ose të ndonjë pjesmarrjeje që Shoqëria ka në shoqëri të tjera;
- n) themelimin, mbylljen dhe/ose likuidimin e degëve, zyrave të përfaqësimit dhe shoqërive të kontrolluara;
- o) çdo lloj shitje, blerje apo transferim të pronave/aseteve të paluajtshme të Shoqërisë tek palë të treta;
- p) mosshpërndarjen e fitimit sipas nenit 21 të këtij Statuti (Shpërndarja e fitimit);
- q) angazhimin e Shoqërisë në çdo biznes tjetër përveç veprimtarisë tregtare të saj;
- r) fillimin ose zgjidhjen e çdo procesi gjyqësor material jashtë rrjedhës së zakonshme të veprimtarisë tregtare;
- s) çdo çështje tjetër e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe/ose ky Statut.

13.2 Nëse shoqëria zotërohet nga një Ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;

d) Vendimet për riorganizimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

#### NENI 14

##### THIRRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe ky Statut, sa herë që mbledhja e saj është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret në përputhje me nenet 83 dhe 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këtë Statut.
- 14.2 Administratori/ët në diskrecionin e tij/tyre, ose me kërkesë të një dhe/ose më shumë Ortakëve që perfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të të gjithë kapitalit të Shoqërisë, dhe/ose audituesit ligjor (nëse ka të tillë) dhe/ose likuiduesit, kanë të drejtë të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme. Një njoftim me shkrim i mbledhjes, duke përmendur qëllimin/et, vendin, datën dhe kohën e mbledhjes, do t'i dorëzohet nëpërmjet postës së regjistruar/e-mailit secilit Ortak jo më herët se 7 (shtatë) ditë para datës së mbledhjes.
- 14.3 Njoftimi i mbledhjes dërgohet me postë të regjistruar dhe/ose e-mail.
- 14.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në ambientet e Shoqërisë ose në ndonjë vend tjetër jashtë tyre, pavarësisht nëse këto vende ndodhen në Shqipëri, ose diku tjetër jashtë Shqipërisë.
- 14.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të bëhen gjithashtu përmes video-konferencave dhe/ose formave të tjera, mjeteve, kanaleve, dhe/ose platformave të komunikimit elektronik, dixhital dhe/ose në internet, për sa kohë që identifikimi i secilit Ortak është i mundshëm teknikisht dhe pasqyrohet siç duhet në procesverbalin e mbledhjes. Në një rast të tillë, detajet specifike se si do të zhvillohet mbledhja do t'u njoftohen Ortakëve përmes një njoftimi zyrtar për mbledhjen.
- 14.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të zhvillohen në gjuhën shqipe. Çdo Ortak ose përfaqësues i Ortakut do të sigurojë shërbimet e përkthimit për veten e tij, nëse nuk ka aftësitë e nevojshme në gjuhën shqipe.



## NENI 15

### PJESËMARRJA NË MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 15.1 Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, duke pasur të drejtë për një numër votash të barabartë me përqindjen e kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 15.2 Secili Ortak ka të drejtë të përfaqësohet në procesin e vendimarrjes nga një Ortak tjetër, nga bashkëshorti ose nga ndonjë person tjetër fizik, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, me kusht që përfaqësuesit të autorizohen me prokurë për një qëllim të tillë.
- 15.3 Administratorët e Shoqërisë mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, por nuk mund të përfaqësojnë asnjë nga Ortakët në ndonjë prej mbledhjeve.

## NENI 16

### KUORUMI DHE VENDIMARRJA

- 16.1 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme në çdo rast është e vlefshme nëse Ortaket që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të Shoqërisë marrin pjesë në mbledhjen përkatëse.
- 16.2 Për vendimet që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me shumicën e votave të Ortakëve të pranishëm në mbledhje në përputhje me pikën 16.1 më lart.
- 16.3 Për vendimet që kërkojnë një shumicë të cilësuar, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e votave të Ortakëve të pranishëm në mbledhje, sipas kuoromit të treguar në pikën 16.1 më lart. Vendime të tilla përfshijnë edhe germat "b", "e", "f", "i", "k", "l", "m", dhe "n" të pikës 13.1, neni 13 i Statutit.
- 16.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të thirret për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 16.1 më lart, Asambleja e Përgjithshme do të thirret përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
- 16.5 Asambleja e Përgjithshme gjithashtu mund të marrë vendime të vlefshme për një vendim qarkullues.



## NENI 17

### PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit të mbledhjes, emrin e sekretarit dhe rezultatet e votimit, si dhe çdo informacion tjetër të detyrueshëm të përcaktuar në dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 17.2 Kryetari i mbledhjes cakton një sekretar/e me qëllim mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, i cili mund të mos jetë Ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe sekretari.
- 17.3 Lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbledhjen e asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve i bashkëlidhen procesverbaleve të mbledhjeve.
- 17.4 Në rastin e vendimeve të marra me anë të një vendimi qarkullues, vendimi duhet të nënshkruhet nga secili Ortak në mënyrë që të jetë i vlefshëm.

## NENI 18

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 18.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) person, i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator sipas ligjit.
- 18.2 Administratori i Shoqërisë emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rinovimi. Administratori mund të shkarkohet përpara mbarimit të mandatit, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.3 Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose dispozitat e legjislacionit në fuqi. Administratori ka të gjitha kompetencat e administrimit të Shoqërisë, përveç atyre kompetencave që janë të rezervuara për organet e tjera të Shoqërisë sipas këtij Statuti dhe/ose legjislacionit në fuqi. Administrimi i jashtëzakonshëm do të jetë i kufizuar dhe nën përgjegjësinë e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.4 Administratori ka dhe ushtron kompetencat dhe detyrat e mëposhtme në lidhje me administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë:



- a) Të mbikëqyrë dhe zbatojë politikat tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
  - b) Me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë masa, të rekomandojë vendime për t'u marrë nga Asambleja e Përgjithshme dhe të zbatojë këto vendime;
  - c) Të sigurojë që shoqëria respekton legjislacionin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit;
  - d) Të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
  - e) Të përfaqësojë Shoqërinë përballë palëve të treta;
  - f) Të sigurojë që dokumentet dhe librat kontabël të Shoqërisë të mbahen si duhet dhe të rregullta;
  - g) Të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur çmohet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
  - h) Të përgatisë dhe të nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë, pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim, së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimeve, si dhe raportet vjetore të ecurisë së Shoqërisë;
  - i) Të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç mund të kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
  - j) T'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare;
  - k) Të miratojë fillimin apo përfundimin e ndonjë procedure ligjore;
  - l) Të kryejë cdo veprim, detyrë, kompetencë dhe/ose akt tjetër sic përcaktohet nga legjislacioni në fuqi dhe/ose ky Statut.
- 18.5 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe të kryejë të gjitha veprimet e ligjshme, detyrat, kompetencat dhe/ose veprimet që në bazë të ligjit, Statutit, apo cdo forme tjetër nuk kërkohet të ushtrohen/kryhen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 18.6 Administratorit, përveç rimbursimit të shpenzimeve të kryera për ushtrimin e funksioneve të tij, do t'i caktohet një shpërblim vjetor total.
- 18.7 Administratori mund të delegojë kompetencat e tij Ortakëve të tjerë ose personave të tretë brenda limiteve të caktuara.
- 18.8 Administratori është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në rastet e administrimit të jashtëzakonshëm.



18.9 Administrator i Shoqërisë emërohet personi më poshtë:

(i) **Z. Frenki Bozo**, atësia Pietri, shtetas shqiptar, identifikuar me Pasaportën nr. BD2848062 dhe me nr. personal J80121052P, lindur më 21/01/1998 në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**KAPITULLI IV**  
**AUDITIM LIGJOR, VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE,**  
**SHPËRNDARJA E FITIMIT**

**NENI 19**  
**AUDITIMI LIGJOR**

Nëse është e nevojshme, ose kërkohet nga ligji, rishikimi i pasqyrave financiare dhe regjistrave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga një auditues i ligjëruar, i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

**NENI 20**  
**VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE**

- 20.1 Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe mbaron më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar shqiptar dhe mbaron më 31 dhjetor të vitit 2024.
- 20.2 Shoqëria duhet të mbajë në menyrë të plotë dhe të saktë librat kontabël të saj në adresën e saj të veprimtarisë, si dhe në vende të tjera të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Këto dokumente, ndër të tjera, duhet të përmbajnë të gjitha të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet e Shoqërisë.
- 20.3 Pasqyrat financiare vjetore dhe, nëse është rasti, raporti i audituesit ligjor miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.



## NENI 21

### SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortakët kanë te drejtë të marrin fitimin e deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Llogaritja e fitimit kryhet në fund të çdo viti financiar. Fitimi shpërndahet midis Ortakëve proporcionalisht me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në kapitalin e Shoqërisë. Në mungesë të një vendimi të kundërt sipas gërmeës "p" të nenit 13.1, Shoqëria shpërndan fitimin çdo vit, në përputhje me nenin 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

## KAPITULLI V

### RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

## NENI 22

### PRISHJA, LIKUIDIMI DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

- 22.1 Shoqëria mund të priset sipas rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Prishja e Shoqërisë do të pasohet nga procedura e likuidimit.
- 22.2 Procedura e likuidimit kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 22.3 Në rast prishjeje vullnetare të Shoqërisë, likuiduesit emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Procedura e likuidimit dhe emërimit të likuiduesve kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 22.4 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore sipas legjislacionit në fuqi. Riorganizimi nuk do të ketë pasoja në të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria ka marrë përsipër kundrejt palëve të treta.

## KAPITULLI VI

### DISPOZITAT PER Fundimtare

## NENI 23

### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I ZBATUESHËM

- 23.1 Shoqëria është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ky Statut është hartuar dhe miratuar në përputhje me këto ligje. Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do




të zbatohen në lidhje me të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara në këtë Statut. Në rast të mospërputhjeve midis dispozitave të këtij Statuti dhe atyre të legjislacionit shqiptar në fuqi, dispozitat e këtij të fundit do të mbizotërojnë.

23.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij Statuti, çdo mosmarrëveshje që lind midis Shoqërisë dhe palëve të treta do të paraqitet për zgjidhje përpara Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ose çdo gjykatë arbitrazhi të rregulluar sipas ligjit shqiptar.

23.3 Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje, me të njejtën vlerë ligjore dhe përmbajtje, në gjuhën Shqipe.

Nënshkruar sot, më 15 /07/2024.

**ORTAKU I VETËM Z. FRENKI BOZO**

Frenki Bozo 



**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“21 ENTERTAINMENT” SHPK**

**NENI 1**

**FORMIMI**

Sot më datë 15 / 07 / 2024 themeluesi që nënshkruan më poshtë:

**Frenki Bozo**, atësia Pietri, shtetas shqiptar, identifikuar me Pasaportën nr. BD2848062 dhe me nr. personal J80121052P, lindur më 21/01/1998, në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Në bazë të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, themelon me vullnet të lirë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtim “21 Entertainment” shpk.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë në adresën: Rruga Naim Frashëri, nr. 36, Tiranë. Selia e shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shoqëria ka të drejtë të hapë filiale në të gjithë vendin.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “21 Entertainment” shpk është pa afat nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “21 Entertainment” shpk është:



Organizimi i aktiviteteve të argëtimit, artit dhe kulturës, duke përfshirë por mos u kufizuar në, festivale, spektakle, sfilata mode, filma, etj. Ofimi i shërbimeve të promovimit dhe menaxhimit si agjent i personave që punojnë në fushën e modelingut. Negocimi dhe mundësimi i marrëdhënieve kontraktore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit me kërkesë dhe në favor të modeleve që punojnë në fushën e modelingut. Promovimi dhe menaxhimi i personave me ndikim në rrjete sociale për marrëdhënie bashkëpunimi me bizneset. Të gjitha aktivitetet e tjera që lejohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi lidhur me fushën e argëtimit, artit, kulturës, promovimit dhe të ndërthurur me fushën e marketingut.

## NENI 5

### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë "21 Entertainment" është 10,000 (dhjetë mijë) lekë dhe i ndarë në 1 (një) kuotë me kontributin e ortakëve si me poshtë:

1. Një kuotë, z. **Frenki Bozo**, në masën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.

Kapitali është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues. Ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të merret nga ortaku/ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë "21 Entertainment" shpk janë:

- Asambleja e Përgjithshme, organi më i lartë vendimmarrës;
- Administrator i shoqërisë, organ drejtues dhe përfaqësues i shoqërisë.

## NENI 7

### ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizik e juridik, vendas apo të huaj, shprehen në Statutin e shoqërisë, që bashkë me Aktin e Themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

## NENI 8



## DISPOZITA TË TJERA

Veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizik ose juridik, si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me mirëkuptim me anë të dispozitave të këtij akti themelimi, statutit si dhe legjislacionit shqiptar. Në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, apo një gjykatë arbitrazhi e rregulluar sipas ligjit shqiptar.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "21 Entertainment" shpk në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pasi shoqëria të fitojë personalitetin e saj juridik.

## ORTAKU I VETËM

Z. Frenki BOZO

Frenki Bozo Frenki